PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE QË APLIKOJNË PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI

- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Arkitekt**
- **Program i Integruar i studimit të ciklit të dytë, Master Shkencor në Arkitekturë, Profili Urbanist**
- **Program i studimit i ciklit të parë, Bachelor në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn**

Kandidatët që aplikojnë për program të dytë studimi duhet të paraqesin pranë sekretarisë mësimore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e aplikimit sipas shtojcës nr. 3
b) Deklaratën sipas shtojcës nr. 1
c) Kopje të njehsuar me origjinalin të diplomës dhe listën e notave/suplementin e diplomës. Të studimeve të arsimit të lartë të kryera më parë
d) Vërtetim të listës së notave dhe krediteve të fituara për çdo lëndë dhe detyrim të shlyer, i cili do të shërbejë për ekuivalentimin e notave të lëndëve të programit të studimit të ndjekur (nëse kërkohet njohja e provimeve të shlyera dhe/ose e krediteve përkatëse)
e) Kopje e njësuar me origjinalin e dëftesës së pjekurisë të shkollës së mesme (për kandidatin që ka përfunduar shkollën e mesme në republikën e shqipërisë përpara vitit 2011). Në mungesë të diplomës së maturës shtetërore apo dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme duhet të paraqesë dublikatë të dëftesës së pjekurisë të lëshuar nga drejtoria e shkollës se mesme dhe të vërtetuar në drap/zvap përkatëse si dhe listën e notave të shkollës se mesme të lëshuar nga arkivi i shtetit
f) Kopje të dokumentit të identifikimit
g) Dy fotografi personale
h) Kopje të mandatpagesës

Kandidatët fitues me diplomë të huaj, në këto programe studimi, i nënshtrohen procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit, si të gjithë kandidatët e tjerë, por regjistrimi i këtyre kandidatëve fitues bëhet me rezervë, pa pasur domosdoshmërisht në momentin e regjistrimit dokumentin e njohjes dhe njësimit të lëshuar nga QSHA.

Shënim:

Kandidati paraqitet personalisht ose nëpërmjet personit të autorizuar prej tij me prokurë.